WHITE PAPER

Rekomandime drejtuar Komisionit të Posaçëm Parlamentar mbi rishikimin e Reformës Administrativo Territoriale, në lidhje me rishikimin e ndarrjes territoriale, përmirësimin e kuadrit legjislativ dhe vijimin e procesit të decentralizimit të funksioneve dhe kompetencave drejtuar njësive të vetqeverisjes vendore.

Ky dokument u hartua nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqiërisë.

Publikues	Datë	Statusi
SHKBSH	**Tetor 2026**	**Versioni Përfundimtar**

Përmbatja

1
Hyrje 3
Metodologjia 3
Gjetje / Konstatime 4
Rekomandime 5
Shtylla 1: Funksionet, shërbimet dhe kompetencat 6
Shërbimet publike 6
Zhvillimi ekonomik vendor 7
Planifikimi urban / administrimi i territorit 7
Pyjet 8
Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve 8
Arsimi parauniversitar 11
Bujqësia 16
Shërbimet sociale 18
Turizmi 18
Kadastra 19
Shërbimi shëndetësor parësor 19
Arsimi professional dhe nxitja e punësimit 19
Shtylla 2: Financat vendore 20
Formula e Transfertës së Pakushtëzuar 20
Taksat e Ndara 26
Shtylla 3: Territori dhe qeverisja 30
Harta territoriale 30
Nivelet e vetëqeverisjes vendore 31
Rritje e nivelit të përfaqësimit 31
Rajonet Zhvillimore – Një Nivel i Ri Territorial 32
Funksionet Rajonale 32
Programet e Kohezionit dhe Partneriteti me BE-në 33
Digjitalizimi 34

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Hyrje

Pas Reformës Administrative Territoriale të miratuar në vitin 2014 dhe të zbatuar pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, miratimi i Ligjit 139/215 "Për vetëqeverisjen vendore", i Ligjit 68/2017 "Për financat vendore", i ligjeve sektoriale dhe i Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore 2015-2020, shënon një hap të madh në drejtim të rritjes së demokracisë vendore, të një qeverisje më të mirë vendore, të konsolidimit financiar dhe administrativ të bashkive të reja, të ushtrimit të më shumë funksioneve dhe kompetencave si dhe krijoi hapësira të reja për decentralizim të më shumë funksioneve drejt 61 bashkive të reja të krijuara rishtaz.

- Administrata vendore është sot më e aftë të përballojë sfidat e kohës dhe forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore ka qënë një prioritet i vazhdueshëm.
- Forcimi i financave vendore nëpërmjet mbështetjes me më shumë buxhet dhe krijimit të më shumë burimeve të vetë financimit, ka krijuar bashki të konsoliduara financiarisht ose në proces konsolidimi.
- Investimet në rritje të realizuara nga ana e bashkive edhe me buxhetet e tyre, ka treguar se bashkimi ka sjellë efektivitet jo vetëm për qytetet, por edhe për periferitë dhe zonat rurale.
- Bashkitë sot ofrojnë më shumë shërbime ndaj banorëve të tyre, shërbime të cilat janë më eficente dhe më cilësore në territore më të gjera se më parë.
- Transferimi i funksioneve, i aseteve dhe buxheteve nëpërmjet transfertave specifike (për një periudhë tranzitore) si dhe rishikimi i legjislacionit sektorial u shoqërua me ofrimin e asistencës së nevojshme për bashkitë, me qëllim garantimin e një transferimi sa më të butë të tyre, pa ndërprerë për asnjë moment shërbimet ndaj qytetarëve.

Hartimi dhe miratimi në vijim i Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SNDQV) 2023-20230, gjithashtu parashikon jo vetëm konsolidimin e funksioneve të transferuara, por edhe decentralizim të mëtejshëm, **me fokus kryesor decentralizimin asimetrik**.

Decentralizimi asimetrik *nuk mbingarkon bashkitë që nuk kanë kapacitete të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të caktuara, por nga ana tjetër nuk pengon vijimin e decentralizimit e funksioneve tek bashkitë pararojë, të afta për marrjen e më shumë kompetencave dhe ushtrimin e tyre me efektivitet dhe eficensë.*

Metodologjia

Ky material u përgatit bazuar në një konsultim të gjërë dhe gjithëpërfshirës të të zgjedhurve vendorë, kryetarë bashkie, kryetarë, sekretarë dhe anëtarë këshillash, drejtues të tjerë vendorë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë aktivë të cilët kanë marrë pjesë në takimet konsultuese

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

dhe kanë shprehur opinionet e tyre që vlerësojnë situatën aktuale dhe rekomandojnë përmirësime të mundshme të vetëqeverisjes vendore dhe shërbimeve ndaj qytetarëve. Ekspertë ndërkombëtarë u angazhuan gjithashtu për vlerësimin e rekomandimeve.

Në finalizimin e këtij dokumenti u ndoqën hapat si vijon:

1. U realizua një bisedë e hapur me kryetarë bashkie dhe u finalizuan mendimet dhe rekomandimet e përbashkëta dhe ato specifike
2. U hartua draft-paper si bazë për diskutim të mëtejshëm.
3. Drafti u prezantua në takime me forumet e kryetarëve të këshillave dhe sekretarëve të këshillave.
4. Mendimi i një eksperti ndërkombëtar me përvojë në fushën e vetëqeverisjes vendore u kërkua me qëllim vlerësimin e opinionit parë nën një vështrim të jashtëm të krahasuar me përvoja ndërkombëtare.
5. Drafti u ballafaqua me vlerësimet dhe rekomandimet e dhëna nga ekspertë dhe qytetarë në takime konsultuese me publikun e gjerë.
6. Sistemimi i rekomandimeve dhe përfshirja e tyre në procesin e përmirësimit të draftit paraprak.
7. Hartimi i dokumentit final të white paper.

Gjetje / Konstatime

Politizimi i diskutimit në lidhje me vlerësimin e Reformës Administrative Territoriale të vitit 2014 si dhe ndarja në "reformë e dështuar" apo "reformë e suksesshme" nuk i shërben procesit dhe vendimmarrjes së nevojshme gjithëpërfshirëse për përmirësime të gjithëpranuara dhe jetëgjatë në lidhje me rishikimin e reformës.
Përpara se të kalohet në konkluzione dhe vendimmarrje, nevojitet që të bihet dakord me disa konkluzione që konsiderohen si të "gjithëpranuara" nga ana e opinionit të gjerë publik.

Pa hyrë në një analizë të detajuar të efekteve të Reformës Administrative Territoriale pas 10 vitesh nga zbatimi i saj, bazuar në të dhënat e institucioneve publike dhe raportet e vlerësimit nga institucione publike, organizata vendase dhe ndërkombëtare, duhet të biem parimisht dakord me disa konkluzione qartësisht të gjithëpranuara dhe të shprehura edhe nga qytetarë dhe përfaqësues të paanshëm në takimet publike:

- Niveli i përfaqësimit në këshillat vendore dhe administratën vendore ka patur përmirësim të ndjeshëm për banorët e qyteteve, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për përfaqësimin e banorëve të zonave rurale.
- Janë rritur ndjeshëm distancat fizike të fshatrave nga qendrat e bashkive (krahasuar me qendrat e ish komunave) dhe nevojitet përmirësim i mëtejshëm i infrastrukturës lidhëse rrugore dhe komunikimit digjital si mjet efikas për "shkurtimin e distancave dhe kohës së

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

ofrimit të shërbimeve publike".

- Ashtu sikurse u konstatua performancë më e mirë e bashkive të mëdha para RAT të vitit 2014 (krahasuar me ish komunat dhe bashkitë e vogla), i njëjti konstatim vlen edhe për 61 bashkitë e reja në performancën e tyre gjatë 10 viteve të fundit.
- Bashkitë përfaqësojnë njësi ekonomike dhe financiare të më të konsoliduara.
- Bashkitë e mëdha ofrojnë në përgjithësi shërbime më efektive dhe më eficente krahasimisht me bashkitë e vogla.
- Shërbimet publike në qytete janë përmirësuar ndjeshëm, ndërkohë që për zonat rurale, nuk mund të thuhet e njëjta gjë dhe nevojitet përmirësim i mëtejshëm dhe forcim i rolit të Njësive Administrative.
- Administrata vendore e bashkive më të mëdha ka burime njerëzore me kapacitete të konsoliduara, ose në proces konsolidimi.
- Investimet publike janë në rritje progresive dhe me tendencë rritje dhe konsolidim të mëtejshëm. Shpërndarja e investimeve ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale, ka nevojë për përmirësim në favor të atyre rurale me qëllim zhvillim të barabartë lokal dhe rajonal.
- Digjitalizimi i të dhënave dhe shërbimeve vendore ka nevojë të zhvillohet më tej, nën modelin e digjitalizimit të të dhenave dhe shërbimeve të qeverisjes qendrore.
- Funksionet e decentralizuara janë ushtruar me kompetencë dhe me tendencë përmirësimi dhe konsolidimi të vazhdueshëm nga ana e bashkive, duke treguar aftësitë e bashkive për të ofruar shërbime më të mira bazuar në parimin themelor të subsidiaritetit. Ka një tendencë për ri-centralizim funksionesh dhe kompetencash e shfaqur në disa fusha.
- Bashkitë përgjithësisht ofrojnë më shumë shërbime, ndërkohë që aftësia për të ofruar shërbime cilësore varion nga njëra bashki tek tjetra bazuar tek specifikat dhe mundësitë e tyre. Asimetria e bashkive ndjehet në sasinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike ndaj banorëve.
- Këshillat e Qarqeve nuk kanë mundur të luajnë rolin e tyre si planifikues dhe koordinues të zhvillimit rajonal, duke vënë në dyshim ekzistencën e tyre dhe duke evidentuar nevojën për transformim rrënjësor të tyre.

Rekomandime

Në vijim jepen disa rekomandime orientuese në lidhje me mundësitë e përmirësimit jo vetëm të hartës territoriale, por edhe të organizimit të veprimtarisë së NJVQV dhe vijimin e procesit të decentralizimit të funksioneve drejt njësive të vetëqeverisjes vendore, të fokusuara në disa drejtime të mundëshme:

- Harta territorial dhe riorganizimi i bashkive
- Nivelet e vetëqeverisjes vendore dhe qartësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit
- Rritja e nivelit të përfaqësimit
- Zhvillimi ekonomik dhe mbështetja e zhvillimit të barabartë vendor.
- Ofrimi i shërbimeve publike në nivel vendor

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

- Digjitalizimi në nivel vendor
- Forcimi i financave vendore
- Thellim i decentralizimit të funksioneve dhe kompetencave ekzistuese
- Decentralizimi i funksioneve të reja

Evidentohet një tendencë centralizimi i funksioneve dhe kompetencave të decentralizuara më parë dhe vecanërisht atyre që lidhen me administrimin e territorit, të ujësjellësave, administrimit të pyjeve dhe kullotave, shërbimeve në fushën e bujqësisë dhe shërbimeve sociale.
Tendenca për centralizim dhe kufizim të kompetencave vendore nëpërmjet akteve nënligjore dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave nevojitet të ndalohet me ligj në respekt të parimit të subsidiaritetit.
Ndalimi i centralizimit të kompetencave dhe shërbimeve vendore, duhet të shoqërohet me rikthimin e tyre tek bashkitë dhe thellimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit.

Krahas thellimit të decentralizimit në fushat e mësipërme, ku paraprakisht janë hedhur hapat e parë, mundësitë për decentralizim funksionesh dhe kompetencash të tjera janë evidente. Parimi i subsidiaritetit duhet të krijojë më shumë mundësi që shërbimet të ofrohen nga ana e institucioneve që janë më pranë qytetarëve.
Në vijim evidentohen disa problematika të shprehura nga ana e qytetarëve në lidhje me shërbime që ofrohen nga institucione qendrore dhe që mund të përmirësohen ndjeshëm në rast të ushtrimit të përbashkët me bashkitë apo të cdecentralizimit të tyre.

Shtylla 1: Funksionet, shërbimet dhe kompetencat

Shërbimet publike

Shërbimet publike dhe përmirësimi i tyre duhet të jenë në fukus të ndarrjes territoriale dhe të përmirësimeve ligjore. Rritja e distancave duhet konsideruar si një faktor që ndikon ndjeshëm në marrjen e shërbimeve për zonat rurale periferike. Fokusi duhet të jetë jo vetëm eficenca e shërbimeve, por në rradhë të parë cilësia dhe barazia e ofrimit të tyre për të gjithë territorin dhe popullsinë.

1. Miratimi i standarteve kombëtare dhe vendore për cdo shërbim publik nevojitet të realizohet me qëllim matjen e cilësisë dhe sasisë së shërbimeve të ofruara në cdo pjesë të territorit.
2. Shërbimet publike në zonat rurale nevojitet të përmirësohen, vecanërisht nëpërmjet ofrimit të tyre nga ana e njësive administrative.
3. Kryetarët e bashkive dhe Këshillat Bashkiake përgjithësisht nuk kanë patur vullnetin dhe gadishmërinë në zbatimin e të drejtës që ju jep Ligji 139/2015 për delegim të kompetencave drejt NjA. Me qëllim krijimin e mundësisë së ofrimit të më shumë shërbimeve nga NJA, ***rekomandohet që ligji të saktësojë më shumë kompetenca***

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

ekskluzive të NjA në ofrimin e shërbimeve direkte ndaj banorëve të tyre.

4. Investimet ne zonat rurale nevojitet të rriten me qëllim "zvogëlimin e distancave" nëpërmjet ***përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale***. Mbështetja e qeverisë kërkohet të jetë më e madhe.
5. Investimet për digjitalizim të shërbimeve në nivelin vendor, nevojitet të jenë prioritet në përputhje me kërkesat e SNDQV, ***duke i shndërruar NjA në sportele (front office) për shërbimet e ofruara nga qendra e bashkisë (back office)***. Mbështetja me financime nga qeveria duhet të materializohet me ligj.

Zhvillimi ekonomik vendor

Bashkitë nevojitet të fokusohen më shumë në drejtim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik vendor. Rritja e rolit të bashkive në drejtim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik vendor dhe barazisë sociale nevojitet të jetë pjesë e një reforme të thellë që krijon kushte dhe mundësi për vendimmarrje lokale që mbështesin biznesin, nxisin punësimin dhe zhvillojnë ekonomine vendore.

1. Nevojitet transferimi i më shumë pronave tek bashkitë me qëllim vënien e tyre në dispozicion të biznesit lokal.
2. Përmirësimet ligjore që i japin më shumë mundësi këshillave bashkiake në vendimmarrje në dobi të zhvillimit ekonomik vendore dhe përdorimit efektiv të aseteve vendore, nevojitet të realizohen.
3. Nevojitet mbështetje për nxitjen e punësimit dhe stimulimin e biznesit të vogël nëpërmjet incentivave të ofruara si nga qeveria ashtu edhe nga bashkitë.

Planifikimi urban / administrimi i territorit

Administrimi i territorit ka pësuar hapa prapa drejt centralizimit dhe forcimit të rolit të institucioneve qendrore. Përvec .cështjeve të tjera, dhenia e lejave të ndërtimit të cdo lloji (në përputhje me planet vendore) duhet të rikthehet si kompetencë e bashkive. Po ashtu qartësimi i rolit të inspektoriateve qendrore dhe vendore nevojitet të qartësohet më tëj.

1. Dhënia e lejave të zhvillimit dhe të ndërtimit duhet të rikthehet si kompetencë e plotë e organeve vendore (edhe për ndërtesa mbi 6 kate), nëpërmjet portalit përkatës, ku bashkia nevojitet të luajë një rol të rendësishëm në ofrimin e asistencës teknike me menaxhimin e procesit. Forcimi i rolit të bashkive si struktura aktive menaxhuese të territorit, me kompetenca operative për të reaguar në kohë reale ndaj zhvillimeve të reja.
2. Vendosja e mekanizmave të detyrueshëm të vlerësimit të kapacitetit real të territorit, para dhe gjatë zhvillimeve me ndikim të qëndrueshëm, ku të përfshihen infrastruktura rrugore, ujësjellës-kanalizimet, energjia, transporti publik dhe menaxhimi i mbetjeve urbane. Këto vlerësime të shërbejnë si bazë për investimet në kohë reale dhe parashikimet për investime publike.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

3. Parashikimi i instrumenteve financiarë dhe kompesues, që mbështesin bashkitë në përballimin e kostove të krijuara nga zhvillimet e reja, në mënyrë që të shmanget kalimi i barrës financiare ne nivel vendor.
4. Krijimi i instrumenteve për vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimit mbi shërbimet publike vendore, siç është arsimi, shëndetësia, shërbimet sociale, hapësirat publike, infrastruktura komunitare. Këto vlerësime të shërbejnë si bazë për investimet dhe parashikimet për investime publike duke lejuar që pushteti vendor të përballojë në mënyrë dinamike zhvillimet dhe rritjen e kërkesës në territorin vendor.
5. Nevojitet qartësimi me ligj i ndarjes së roleve dhe kompetencave në territor ndërmjet inspektoriateve të ndërtimit kombëtar dhe vendor, me qëllim moslejimin e ndërhyrjeve arbitrare në territorin e administruar nga bashkitë.

Pyjet

Me decentralizimin e funksionit të administrimit dhe menaxhimit të pyjeve, gati 80% e sipërfaqes pyjore është nën administrimin e bashkive. Janë ngritur strukturat përkatëse dhe gradualisht po pregatiten plane të mbarështimit të tyre.

1. Problematika lidhur me këtë sektor lidhet me bashki specifike dhe nuk është e përgjithshme. Bashkitë të cilat kanë në territorin e tyre zona të mbrojtura, identifikojnë probleme lidhur me tarifa të larta të marrjes në përdorim të sipërfaqeve pyjore të ndodhura në zonat e mbrojtura krahasuar me tarifat e aplikuara nga bashkitë. Gjithashtu, prania në masë të madhe e zonave të mbrojtura në territorin e një bashkie redukton shumë mundësinë e krijimit të të ardhurave në nivel vendor. Sugjerojmë që bashkive t'ju krijohen hapësira ligjore që të ndërhyjnë në zgjidhjen e problematikave mbi marrjen e tokës në përdorim dhe në zonat e mbrojtura.
2. Iniciativa e propozuar për krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve shënon një hap pas të decentralizimit të ndërmarrë në 2016 pasi parashikohet të jetë kjo Shoqëri e cila do të menaxhojë të gjithë fondin pyjor publik.

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve

Kuadri i ri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve është ambicioz dhe i domosdoshëm për rrugëtimin drejt BE-së. Megjithatë, do te duhet qe bashkitë te pajisen me mjetet, burimet dhe autonominë e nevojshme.

Tre parime duhet të udhëheqin këtë proces:

1. Objektivat, ndryshimet ligjore dhe sanksionet duhet të ndjekin kurbën realiste të kapaciteteve të bashkive.
2. Detyrat e bashkive duhet të jenë proporcionale me mbështetjen financiare, teknike dhe institucionale nga niveli qendror.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

3. Bashkitë të jenë bashkëhartues të standardeve, modeleve dhe instrumenteve që ato kanë për detyrë të zbatojnë dhe të mos konsiderohen vetëm zbatuese të orientimeve dhe vendimeve të ministrive të linjës apo institucioneve qendrore.

Miratimi vitin e kaluar të ligjit Nr. 57/2025 datë 16.10.2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe Ligjit Nr. 74/2025 datë 04.12.2025 "Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje", shënojnë një ndryshim themelor në arkitekturën e menaxhimit të mbetjeve urbane në Shqipëri. Bashkive u ngarkohen detyra dhe përgjegjësia për menaxhimin e integruar të mbetjeve , duke nisur që nga grumbullimi i diferencuar sipas gjashtë rrymave specifike, hartimi i planeve vendore, hartimi i programeve të parandalimit të mbetjeve, koordinimi i zonave të mbetjeve, grumbullimi dhe raportimi i të dhënave deri tek ndërgjegjësimi dhe edukimi. Njëkohësisht, Ligji Nr. 74/2025 duke futur sistemin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP), kërkon tashmë një bashkëpunim të drejtpërdrejtë midis Shoqërive të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesve (SHPZP-ve) dhe bashkive.

Disa prej sfidave me të cilat përballen bashkitë, janë:

- Rritja e detyrave pa transferim proporcional të kompetencave vendimmarrëse, standardeve të qarta dhe autonomisë për të përcaktuar prioritete.
- Infrastruktura e grumbullimit të diferencuar, stacionet e transferimit dhe kostot e transportit drejt vendeve të trajtimit fundor janë tej kapaciteteve buxhetore të shumicës së bashkive.
- Mungesa të stafit të kualifikuar teknik për ngritjen dhe operimin e sistemeve të MIM nëpër bashki.
- Mungesa e mbajtjes së një sistemi të dhënash, peshimit dhe mungesa e aksesit në informacionin e impianteve fundore e bën të pamundur grumbullimin dhe raportimin e të dhënave të sakta. Gjithashtu rreziku i raportimit të ndryshëm apo të dyfishtë midis Ministrive të linjës, AKEM, AKM dhe INSTAT është prezent.

Bashkitë nuk mund të jenë institucione me "përgjegjësi të plotë" për MIM-in pa pasur kompetencat, standardet dhe autonominë e nevojshme vendimmarrëse.

Rekomandimet e mëposhtme synojnë të mbyllin këtë hendek.

1. Bashkitë së bashku me institucionet qendrore të punojnë për hartimin dhe miratimin e **një Standarti Minimal të menaxhimit të mbetjeve për nivel vendor**, i cili të shërbejë më pas si pikë referimi për vlerësimin e performancës bashkiake në këtë sektor dhe në llogaritjen e kostove të shërbimit sipas modelit të kostos.
2. Bashkitë të kenë autoritetin ligjor të përcaktojnë **vetë rendin e prioriteteve për ngritjen e sistemit të grumbullimit të diferencuar sipas gjashtë rrymave** (letër, plastikë, metal, qelq, bio, tekstile), duke marrë parasysh kapacitetet ekzistuese dhe veçoritë territoriale**. Aktet nënligjore duhet të parashikojnë një periudhë tranzitore nga hyrja në fuqi e ligjit,** gjatë së cilës bashkitë të marrin masa për ta bërë këtë kuadër ligjor realisht të zbatueshëm dhe jo

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

të ngelen akte në letër, vetëm për hir të plotësimit të objektivave të përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së.

3. Ngarkesa financiare e parashikuar nga ligjet e reja për grumbullim të diferencuar, qendra për ndarje dhe ripërdorim, stacione transferimi, transport drejt trajtimit fundor etj. tejkalojnë ndjeshëm kapacitetet buxhetore të shumicës dërrmuese të bashkive shqiptare. Mekanizma financiarë të strukturuar qartë nga niveli qendror mund të lehtësojnë këtë hendek me fonde të dedikuara nevojave të bashkive dhe zonave të mbetjeve.
4. Një tjetër rekomandim lidhet me **forcimin e bashkëpunimit ndërmjet bashkive dhe skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit** (SHPZP-ve), në mënyrë që kostot dhe përgjegjësitë për grumbullimin dhe riciklimin të ndahen më drejt ndërmjet bashkive dhe sektorit privat. Kuadri nënligjor duhet të përcaktojë më qartë rolin operacional dhe financiar të këtyre strukturave në mbështetje të bashkive. Tarifat e PZP-së (Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit) si burim financimi vendor, të adresojnë problematikën e shumë bashkive të vogla të cilat nuk gjejnë operatorë blerës për sasitë e kufizuara të mbetjeve të riciklueshme.
5. Bashkitë duhet të kenë një njësi të dedikuar për mjedisin dhe mbetjet, të trajnuar dhe të aftë të përballojnë përgjegjësitë në rritje për sektorin.
6. Bashkitë duhet të mbështeten me programe të vazhdueshme trajnimi për administratën vendore mbi planifikimin e menaxhimit të mbetjeve, menaxhimin e kontratave, raportimin e të dhënave dhe monitorimin e performancës.
7. Të funksionalizohet **e-Intrumenti për matjen e performancës** së sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve pranë AKEM-it. Ky instrument ndihmon AKEM dhe bashkitë për grumbullimin dhe raportimin e të dhënave për mbetjet, monitorimin në kohë reale të treguesve kryesorë të përformancës (KPI-ve) si dhe prodhimin e raporteve për bashkitë dhe institucionet, duke eliminuar raportimin e dyfishtë.
8. Nevojitet **qartësimi i pronësisë dhe kushtet e operimit të impianteve fundore**. Statusi i ri i AKEM si shoqëri aksionere, së cilës do t'i kalojë shërbimi i trajtimit fundor të mbetjeve dhe çdo shërbim tjetër, në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj, duhet të konsiderojë pronësinë mbi impiantet fundore të trajtimit kur ndodhen në pronësinë e një apo disa bashkive të caktuara, kushtet e operimit, negociimin e tarifave hyrëse në landfill, përfshirë detyrimet e transparencës ndaj bashkive. Në një të ardhme të afërt, bashkitë mund të kenë nevojë të ndërtojnë vetë impiante fundore të menaxhimit apo dhe për depozitimin e mbetjeve. Legjislacioni aktual me rajonalizimin e impianteve nuk e lejon këtë. Sugjerojmë që bashkitë duhet të kenë mundësi të ndërtojnë landfille në tërritoret e tyre përmes të cilave mund të krijojnë dhe të ardhura përmes riciklimit.

   Të parashikohet me akte nënligjore publikimi vjetor i vlerësimit të performancës së bashkive mbi MIM-in, bazuar në monitorimin e treguesve kryesorë të përformancës (KPI-ve). Bashkitë me performancë të lartë të fitojnë akses prioritar në fondet për mjedisin apo grante. Kjo transparencë krijon nxitje pozitive dhe stimulon bashkitë të investojnë në sistem.
9. Sektori informal i grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, operon gjerësisht në territoret e bashkive të mëdha, shpesh duke ndërhyrë në kontenierët bashkiakë dhe duke penguar funksionimin e sistemit të MIM. Ky sektor, nëse formalizohet, mund të shndërrohet nga

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

problem në pasuri. Aktet nënligjore të mund të parashikojnë një rrugë të qartë dhe ekonomikisht të arritshme të formalizimit të grumbulluesve informal si Agjentë të licencuar sipas Ligjit 57/2025. Kjo të përfshijë kushte të lehtësuara për grumbulluesit informal kryesisht për licencimin e tyre, si dhe stimuj financiarë nga SHPZ-të dhe fondet e mjedisit për integrimin e tyre në rrjetin e grumbullimit.

10. Sa i përket arritjes së objektivave dhe treguesve për grumbullimin e diferencuar dhe riciklimin, rekomandohet standardizimi në nivel kombëtar i elementeve bazë të sistemit, si kodi i ngjyrave për kontenierët dhe formatet e raportimit, për të lehtësuar komunikimin publik, monitorimin dhe zhvillimin e fushatave kombëtare të ndërgjegjësimit.
11. Në një perspektivë afatgjatë, rekomandohet që qeverisja e sektorit të mbështetet më shumë në modele rajonale dhe ndërvendore të bashkëpunimit, në mënyrë që bashkitë të ndajnë kostot dhe infrastrukturën e trajtimit, duke rritur eficiencën ekonomike dhe qëndrueshmërinë e sistemit. Një qasje e tillë do të ndihmonte në krijimin e një sistemi më funksional, më të koordinuar dhe më pranë standardeve të Bashkimit Evropian në sektorin e mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Arsimi parauniversitar

Arsimi parauniversitar dhe shërbimet e hershme për fëmijët janë ndër fushat ku reforma territoriale dhe decentralizimi funksional mund të japin ndikimin më të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Përvoja e deritanishme e arsimit parashkollor ka treguar se bashkitë janë në gjendje të administrojnë shërbime komplekse, të planifikojnë investime, të sigurojnë mirëmbajtjen e infrastrukturës, të organizojnë shërbime mbështetëse dhe të përshtatin ofrimin e shërbimit me nevojat konkrete të komuniteteve.

Megjithatë, kjo përvojë ka treguar gjithashtu se decentralizimi nuk mund të kuptohet vetëm si transferim përgjegjësish. Ai duhet të shoqërohet me autoritet real vendimmarrës, financim të mjaftueshëm, standarde kombëtare të qarta, mekanizma të drejtë financimi, sisteme të dhënash dhe procedura të zbatueshme në praktikë. Analizat e ecurisë së këtij procesi evidentojnë ende mbivendosje kompetencash ("de jure" vs "de facto") dhe dualizëm institucional ndërmjet pushtetit vendor dhe Ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Në këtë kuadër, kryetarët e bashkive vlerësojnë se reforma territoriale duhet të shoqërohet me një fazë të re të decentralizimit funksional në arsim, duke konsoliduar çerdhet dhe arsimin parashkollor, si dhe duke rritur gradualisht rolin e bashkive në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm.

1. **Të qartësohet ndarja e përgjegjësive ndërmjet Ministrisë së Arsimit, strukturave të saj dhe bashkive**

Aktualisht, në arsimin parashkollor dhe në disa procese të arsimit parauniversitar, bashkitë mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejta për ofrimin e shërbimit, ndërsa disa vendime thelbësore

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

vijojnë të kontrollohen ose ndikohen nga niveli qendror dhe strukturat e dekoncentruara. Kjo krijon mbivendosje kompetencash, paqartësi në vendimmarrje dhe vështirësi në llogaridhënie.

Rekomandohet rishikimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për arsimin parauniversitar, me qëllim përcaktimin e qartë të përgjegjësive të secilit aktor: çfarë përcakton Ministria e Arsimit, çfarë monitorojnë DRAP/ZVAP, çfarë administron bashkia dhe për çfarë mban përgjegjësi drejtuesi i institucionit arsimor.

Ministria e Arsimit duhet të ruajë rolin e saj në përcaktimin e kurrikulës, standardeve kombëtare, kritereve profesionale, sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të sistemit. Ndërkohë, bashkitë duhet të kenë autoritet të qartë mbi organizimin vendor të shërbimit, planifikimin e rrjetit arsimor, mirëmbajtjen, investimet, shërbimet mbështetëse, raportimin vendor dhe përshtatjen e shërbimit me nevojat e komunitetit.

Në praktikë, kjo kërkon një akt të posaçëm ose paketë aktesh nënligjore që të ndajë proceset sipas funksioneve: regjistrimi, frekuentimi, mirëmbajtja, materialet didaktike, stafi mbështetës, transporti, ushqimi, siguria, përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe raportimi i të dhënave. Bashkitë janë ofruesit kryesorë të shërbimit, por ndarja me Ministrinë, ZVAP dhe agjencitë e tjera nuk është plotësisht e qartë dhe ka mbivendosje në planifikim, monitorim, raportim dhe zhvillim stafi.

2. **Çerdhet dhe arsimi parashkollor të konsolidohen si sistem vendor i zhvillimit të hershëm 0–6 vjeç**

   Çerdhet nuk duhet të trajtohen vetëm si shërbim social apo shëndetësor i veçuar, por si pjesë e sistemit të integruar të zhvillimit të hershëm të fëmijës. Bashkitë janë institucioni më pranë familjeve dhe kanë mundësi të lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë çerdhen, kopshtin, shërbimin social, mbrojtjen e fëmijës dhe shëndetin parësor.

   Rekomandohet që çerdhet dhe arsimi parashkollor të trajtohen si një cikël i lidhur vendor 0–6 vjeç, ku bashkia mban përgjegjësi për administrimin, planifikimin, mirëmbajtjen, aksesin, personelin mbështetës dhe organizimin e shërbimit, ndërsa ministritë përgjegjëse përcaktojnë standardet kombëtare për shëndetin, ushqyerjen, sigurinë, zhvillimin e hershëm, mbrojtjen e fëmijës dhe cilësinë pedagogjike.

   Në nivel politikash, kjo kërkon një qasje të përbashkët ndërmjet arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, në mënyrë që shërbimet për fëmijën të funksionojnë si sistem i lidhur dhe jo si përgjegjësi të ndara ndërmjet institucioneve.

3. **Të decentralizohet gradualisht administrimi i burimeve njerëzore dhe portali "Mësues për Shqipërinë"**

   Në arsimin parashkollor, bashkitë mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ofrimin e shërbimit, por përzgjedhja e mësuesve mbetet praktikisht e lidhur me një mekanizëm qendror. Kjo krijon

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

një mospërputhje ndërmjet përgjegjësisë që ka bashkia për shërbimin dhe autoritetit që ajo ka mbi burimet njerëzore — duke e bërë përgjegjësinë e bashkisë jo të plotë.

Rekomandohet që administrimi i pjesës së portalit "Mësues për Shqipërinë" për arsimin parashkollor të kalojë gradualisht te bashkitë, duke respektuar kriteret profesionale, standardet kombëtare dhe kontrollin e ligjshmërisë nga Ministria e Arsimit. Bashkia duhet të ketë mundësi të shpallë nevojat, të administrojë procesin, të përzgjedhë kandidatët sipas renditjes dhe kritereve të miratuara, si dhe të planifikojë zhvillimin profesional të stafit në përputhje me nevojat lokale.

Në një fazë të dytë, ky model mund të shtrihet gradualisht edhe në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm të përgjithshëm, sidomos në bashkitë që kanë kapacitete të konsoliduara administrative. Ky rekomandim nuk nënkupton dobësim të standardeve kombëtare, por vendosjen e një modeli ku Ministria përcakton standardet, kurrikulën dhe kriteret profesionale, ndërsa bashkitë administrojnë në mënyrë më të drejtpërdrejtë proceset vendore të burimeve njerëzore.

4. Financimi të ndjekë funksionin dhe fëmijën/nxënësin

Decentralizimi nuk mund të jetë i suksesshëm nëse bashkive u shtohen përgjegjësi pa burime të mjaftueshme. Formula aktuale e financimit për arsimin parashkollor, atë bazë dhe të mesëm nuk pasqyron të gjitha kostot reale të shërbimit, pasi nuk përfshin në mënyrë të plotë stafin mbështetës, mësuesit ndihmës, psikologët, materialet didaktike, mirëmbajtjen, trajnimin, ushqimin dhe transportin. Për shkak se kapaciteti fiskal i bashkive është i ndryshëm, decentralizimi mund të krijojë pabarazi territoriale nëse financimi nuk ka mekanizma barazues. Bashkitë me territor të gjerë rural, me popullsi të shpërndarë, me më shumë fëmijë në nevojë ose me infrastrukturë të amortizuar kanë kosto më të lartë shërbimi.

Rekomandohet hartimi i një metodologjie kombëtare për koston standarde për fëmijë/nxënës, e cila të zbatohet për çerdhet, arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kostoja standarde duhet të llogarisë jo vetëm pagën e mësuesit, por të gjithë paketën e shërbimit: infrastrukturën, ngrohjen, ujin, energjinë, mjetet didaktike, sigurinë, transportin, ushqimin aty ku aplikohet, shërbimin psikosocial, mësuesin ndihmës dhe mbështetjen për fëmijët në nevojë.

Rekomandohet gjithashtu që në buxhetin vendor dhe atë qendror të ndahen qartë zërat për: çerdhe, arsim parashkollor, arsim bazë dhe arsim të mesëm. Siç ka rezultuar, përzierja e financimit të arsimit parashkollor me arsimin bazë dobëson transparencën, e bën të vështirë raportimin dhe nuk lejon vlerësimin real të kostos së shërbimit.

5. Të krijohet një grant i dedikuar dhe barazues për arsimin parauniversitar

Kapaciteti fiskal i bashkive është i ndryshëm. Bashkitë me territor të gjerë rural, me popullsi të shpërndarë, me më shumë fëmijë në nevojë, me infrastrukturë të amortizuar ose me kosto më të lartë transporti përballen me barrë më të madhe financiare. Për këtë arsye, financimi i arsimit parauniversitar duhet të ketë mekanizma barazues.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Rekomandohet krijimi i një granti të dedikuar për arsimin parauniversitar, duke përfshirë nëndarjen për të gjithë nënkomponentët (çerdhe, kopshte, arsim bazë, arsim i mesëm i përgjithshëm). Ky grant duhet të bazohet në koston standarde, numrin e fëmijëve dhe nxënësve, distancat territoriale, nivelin e varfërisë, numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, gjendjen e infrastrukturës dhe nevojën për transport.

Ky mekanizëm do të mundësonte që çdo fëmijë, pavarësisht bashkisë ku jeton, të ketë akses në një standard minimal shërbimi. Financimi nuk duhet të bazohet vetëm në tregues historikë apo në numër të përgjithshëm nxënësish, por në nevojën reale për të garantuar shërbim cilësor, të sigurt dhe gjithëpërfshirës.

6. Të miratohet një paketë kombëtare e standardeve minimale të shërbimit

Standardet kombëtare janë të domosdoshme për të garantuar barazi minimale në të gjithë territorin. Standardet kombëtare duhet të jenë të qarta, të matshme dhe të lidhura me financimin. Nuk mjafton të vendosen detyrime ligjore në mënyrë të shpërndarë në akte të ndryshme. Bashkitë kanë nevojë për një paketë të unifikuar standardesh minimale për çerdhet, kopshtet, shkollat 9-vjeçare dhe shkollat e mesme.

Këto standarde duhet të mbulojnë: raportin fëmijë/mësues, hapësirat minimale, sigurinë, higjienën, aksesin për fëmijët me aftësi të kufizuara, materialet didaktike, laboratoret, shërbimin psikosocial, ushqimin, transportin, funksionimin e bordeve dhe raportimin e të dhënave.

Në nivel politikash, standardet duhet të shërbejnë si garanci kombëtare për qytetarët. Në nivel zbatimi, ato duhet të shoqërohen me kosto, burim financimi, afat për përmbushje dhe mekanizëm monitorimi.

7. Arsimi gjithëpërfshirës të financohet si pjesë e detyrueshme e shërbimit

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve nga familje në nevojë, komuniteteve rome dhe egjiptiane, fëmijëve në zona rurale dhe atyre me vështirësi sociale nuk mund të lihet në varësi të mundësive financiare të secilës bashki. Nëse nuk financohet si pjesë e detyrueshme e shërbimit, gjithëpërfshirja mbetet objektiv formal.

Rekomandohet që në formulën e financimit të përfshihen kostot për mësues ndihmës, psikologë, punonjës socialë, përshtatje infrastrukturore, transport, ushqim dhe materiale bazë për fëmijët në nevojë. Për fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të ketë financim të dedikuar, të lidhur me planin individual të mbështetjes.

8. Të forcohet roli i bashkive në licencimin dhe monitorimin e institucioneve jopublike

Institucionet jopublike të arsimit dhe kujdesit për fëmijët janë pjesë e realitetit vendor, por bashkitë shpesh nuk kanë rol të mjaftueshëm në verifikimin e kushteve lokale, sigurisë, kapacitetit real, aksesit dhe ndikimit në territor.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Rekomandohet që bashkitë të kenë rol të detyrueshëm në procesin e verifikimit paraprak, dhënies së mendimit vendor dhe monitorimit periodik të çerdheve, kopshteve, institucioneve të tjera jopublike të arsimit parauniversitar dhe të kujdesit për fëmijët. Ky rol nuk zëvendëson kompetencat e ministrive apo strukturave kombëtare, por siguron kontrollin lokal mbi kushtet konkrete të funksionimit: godina, siguria, higjiena, kapaciteti, aksesueshmëria, distanca, ndikimi në komunitet dhe përputhja me planifikimin vendor.

9. Të lehtësohet bashkëpunimi ndërbashkiak për shërbimet arsimore

Në shumë zona rurale, numri i fëmijëve është i ulët, distancat janë të mëdha dhe kostoja e shërbimit është më e lartë. Në këto raste, zgjidhjet vetëm brenda kufijve të një bashkie mund të jenë të kushtueshme ose joefektive.

Rekomandohet që kuadri ligjor të mbështesë krijimin e shërbimeve ndërbashkiake për çerdhe, kopshte, transport shkollor, shërbim psikosocial, mësues ndihmës dhe shërbime të specializuara. Për fëmijët që ndjekin shërbimin në një bashki tjetër, duhet të ketë skemë kompensimi financiar ndërmjet bashkive dhe rregulla të qarta për regjistrimin, transportin dhe përgjegjësinë administrative.

Ky mekanizëm do të ndihmonte veçanërisht bashkitë e vogla, zonat rurale dhe territoret me popullsi të shpërndarë, ku ofrimi i çdo shërbimi brenda kufirit administrativ të bashkisë nuk është gjithmonë zgjidhja më efektive.

10. Të krijohet një regjistër kombëtar i të dhënave për arsimin vendor

Një nga boshllëqet kryesore është mungesa e një sistemi të unifikuar të të dhënave për arsimin parashkollor dhe më gjerë për arsimin vendor. Pa të dhëna të sakta mbi fëmijët rezidentë, frekuentimin, stafin, infrastrukturën, fëmijët me aftësi të kufizuara, nevojat për transport dhe investime, bashkitë nuk mund të planifikojnë me cilësi dhe qeveria qendrore nuk mund të financojë me drejtësi.

Rekomandohet krijimi i një regjistri kombëtar të arsimit vendor, të lidhur me gjendjen civile, me sistemet e Ministrisë së Arsimit dhe me raportimin e bashkive. Regjistri duhet të përfshijë fëmijët 0–6 vjeç për çerdhe dhe parashkollor, nxënësit e arsimit bazë dhe të mesëm, frekuentimin real, kapacitetet e institucioneve, stafin, infrastrukturën, nevojat për shërbime mbështetëse dhe indikatorët e cilësisë.

Ky regjistër duhet të përdoret edhe për planifikimin e investimeve, për subvencionet, për transportin shkollor dhe për monitorimin e standardeve. Dokumentet evidentojnë se sistemi i monitorimit dhe të dhënave mbetet i fragmentuar, ndërsa rekomandohen sisteme të standardizuara të të dhënave, plane përmirësimi dhe raporte krahasuese për bashkitë.

11. Decentralizimi në arsim të jetë gradual dhe asimetrik, por me standarde të njëjta kombëtare

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Jo të gjitha bashkitë kanë të njëjtin kapacitet administrativ, financiar dhe njerëzor. Për këtë arsye, zgjerimi i kompetencave në arsimin bazë dhe të mesëm duhet të bëhet gradualisht dhe, aty ku është e nevojshme, në mënyrë asimetrike.

Rekomandohet që decentralizimi në arsim të zhvillohet me faza. Faza e parë duhet të konsolidojë plotësisht çerdhet dhe arsimin parashkollor si përgjegjësi vendore. Faza e dytë duhet të forcojë rolin e bashkive në arsimin bazë, veçanërisht në planifikim, infrastrukturë, shërbime mbështetëse, transport, siguri dhe të dhëna. Faza e tretë mund të shtrihet në arsimin e mesëm të përgjithshëm, sidomos për administrimin e shërbimeve mbështetëse, planifikimin territorial, investimet dhe gradualisht burimet njerëzore.

Bashkitë me kapacitete më të konsoliduara mund të marrin më shpejt përgjegjësi të zgjeruara, ndërsa bashkitë me kapacitete më të kufizuara duhet të mbështeten me trajnime, financim dhe asistencë teknike. Në çdo rast, standardet kombëtare të cilësisë duhet të jenë të njëjta për të gjithë vendin.

Masa ligjore, nënligjore dhe proceduriale të propozuara

Për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme, kryetarët e bashkive propozojnë ndërmarrjen e paketës së mëposhtme:

1. Rishikimi i Ligjit për arsimin parauniversitar, për të qartësuar kompetencat e bashkive në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm.
2. Rishikimi i akteve që rregullojnë portalin "Mësues për Shqipërinë", për të mundësuar administrimin gradual vendor të pjesës që lidhet fillimisht me arsimin parashkollor dhe më pas me arsimin parauniversitar.
3. Miratimi i metodologjisë kombëtare të kostos standarde për fëmijë/nxënës.
4. Krijimi i një granti të dedikuar dhe barazues për arsimin parashkollor dhe komponentët mbështetës të arsimit parauniversitar.
5. Ndarja e qartë e financimit buxhetor për çerdhet, arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm.
6. Miratimi i paketës kombëtare të standardeve minimale të shërbimit për çerdhe, kopshte dhe shkolla (arsim bazë dhe të mesëm të përgjithshëm).
7. Rishikimi i procedurave për verifikimin, licencimin dhe monitorimin e institucioneve jopublike, duke përfshirë detyrimisht bashkitë në dhënien e mendimit vendor dhe monitorimin e vazhdueshëm.
8. Krijimi i bazës ligjore për shërbime arsimore ndërbashkiake dhe për kompensim financiar ndërmjet bashkive.
9. Krijimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi për strukturat e administrimit të shërbimit të arsimit në bashki.

Bujqësia

Megjithëse ka patur përpjekje reale për angazhimin e bashkive në ofrimin e shërbimeve në fushën e bujqësisë, përvec angazhimit të shtuar nga ana e bashkive, konstatohet hezitim nga ana e

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

institucioneve të dekoncentruara për bashkëpunim dhe koordinim. Transferimi i kompetencave nuk ka ndjekur logjikën funksionale të sistemit. Sistemi i ujitjes dhe kullimit është projektuar historikisht si një sistem integral, ku funksionimi i çdo komponenti varet nga funksionimi i tërësisë. Transferimi i segmenteve të ndryshme të sistemit ndërmjet aktorëve të ndryshëm institucionalë ka krijuar fragmentim të përgjegjësive dhe vështirësi serioze në menaxhim.

Problematika bëhet më e ndjeshme në rastet kur bashkive u janë transferuar asete me rëndësi strategjike dhe me nivel të lartë risku, si hidrovore apo diga të mesme, pa kapacitete të mjaftueshme teknike dhe financiare për administrimin e tyre.

Mungesa e standardeve të përditësuara krijon vështirësi edhe në përllogaritjen reale të kostove gjatë procedurave të prokurimit për ndërtimin apo rehabilitimin e infrastrukturës ujitëse dhe kulluese.

Administrimi i kanaleve dytësore dhe të treta ka një përmirësim evident, ndëkohë që koordinimi me drejtoritë qëndrore të administrimit të ujërave nuk shënon të njëjtat rezultate.
Zyrat e dekoncentruara të ekstensionit bujqësor janë të dubluara me ato të bashkive, duke krijuar një dualitet të panevojshëm.
Të dhënat e tokës, të fermave dhe fermerëve, të blegtorisë dhe hartat përkatëse vijojnë të jenë "pronësi" e institucioneve qëndrore dhe nuk ndahen më bashkitë.
Bashkitë nuk janë palë në procesin e mbështetjes dhe financimit të fermerëve dhe projekteve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.
Bazuar në vlerësimet e mësipërme, konkludohet se:

1. Prej vitit 2016 bashkitë ushtrojnë funksionin e administrimit të ujitjes dhe kullimit nëpërmjet administrimit të kanaleve ujitëse të nivelit të parë dhe pjesërisht edhe të nivelit të dytë, përfshirë një pjesë të digave dhe rezervuareve.
2. ***Rekomandohet rishikimi i inventarit të kanaleve dhe veprave ujitëse të transferuara tek bashkitë, duke shtuar administrimin "end to end" të kanaleve sekondare dhe terciale me menaxhim bashkiak / ndërbashkiak.***
3. ***Asistenca dhe konsultimi në fushën e bujqësisë (ekstesion)***, megjithëse nuk ndalohet nga ligji për t'u ofruara edhe nga departamentet e bashkive, nevojitet të sanksionohet me ligj duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e bashkive në fushën e ofrimit të shërbimit të këshillimit për fermerët. Bashkitë disponojnë inventare të tokave bujqësore, fermave, blegtorisë dhe kollotave si dhe kapacitete njerëzore në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, të afta për të asistuar në cdo aspect të këshillimit bujqësor dh blegtoral.
4. ***Subvencionimi dhe financimi i projekteve në fushën e bujqësisë*** duhet të jetë një funksion i përbashkët midis bashkive dhe strukturave qendrore të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë (AZHBR), bazuar në parimin e subsidiaritetit. Bashkitë janë të afta mjaftueshëm dhe kanë kapacitetet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e bujqësisë me asistencë dhe financime nëpërmjet transfertave të kushtëzuara.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

5. Qartësimi i kuadrit ligjor dhe përcaktimi i qartë i përgjegjësive institucionale;
6. Rivlerësimi i modelit aktual të organizimit të sistemit mbi baza funksionale dhe jo vetëm administrative;
7. Përditësimi i standardeve teknike të sektorit; Mungesa e standardeve të përditësuara krijon vështirësi edhe në përllogaritjen reale të kostove gjatë procedurave të prokurimit për ndërtimin apo rehabilitimin e infrastrukturës ujitëse dhe kulluese.
8. Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të financimit;
9. Forcimi i koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore.

Shërbimet sociale

"Fondi social" administrohet nga ana e ministrisë përgjegjëse për cështjet sociale, duke ulur ndjeshëm rolin e bashkive në angazhimin për mbrojtej sociale të banorëve të saj. Ndërkohë që drejtoritë përkatëse të shërbimeve sociale në bashki realizojnë evidentimin e nevojave dhe të individëve përkatës, ato vetëm formalisht miratojnë mbështetjen sociale, pa patur mundësi të menaxhojnë një buxhet social në përputhje me nevojat dhe kushtet specifike të tyre. Nxitja e parazitizmit dhe e përfitimit financiar dhe lehtësi të tjera duhet të luftohet nëpërmjet krijimit të mekanizmave efektivë që nxitin punësimin dhe orientojnë mbështetjen sociale tek ata që kanë nevojë.

Në këtë situatë rekomandohen masat në vijim:

1. Dhenia e ndihmës financiare për të papunët dhe shtresat në nevojë, nevojitet të mbështetet me programe që krijojnë mundësi punësimi duke krijuar mundësi alternative për pagesa nëpërmjet punës në komunitet.
2. ***Krijimi i "fondit social"*** në bashkëpunim me ministrinë përkatëse dhe administrimi i tij i pavarur nga bashkia në vartësi të nevojave të evidentuara në kushtet specifike të cdo bashkie.
3. Nevojitet të jepet mundësia e ofrimit të shërbimeve sociale ndaj shtresave në nevojë edhe në forma të tjera, përvec atyre të trajtimit në qendra rezidente sociale.
4. Kërkohen më shumë kompetenca dhe të drejta vendimmarrjen në ***krijimin dhe administrimin e qendrave sociale.***

Turizmi

Shqipëria po kthehet gjithnjë e më shumë në një destinacion të preferuar botërisht për turizëm, duke përfshirë gjithnjë e më shumë të gjitha llojet e turizmit.

Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin dhe mbështetjen e shërbimeve në fushën e mikpritjes dhe turizmit, pa të cilën do të ishte e pamundur të arriheshin rezultatet positive dhe numri në rritje i turistëve.

Ndërkohë që nga ana e bashkive ofrohen shërbimet kryesore ndaj turistëve, ka patur një tendencë në rritje për centralizim të disa kompetencave duke ju kaluar institucioneve qendrore, larg nga shërbimet dhe në pamundësi të njohjes së karakteristikave specifike. Lejat për stacione plazhi dhe shërbime të tjera janë centralizuar dhe shumë destinacioni turistike administrohen nga institucione

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

qendrore, duke krijuar mbivendosje kompetencash dhe mundesi për koordinim të dobët dhe me pasoja.
Në këtë situatë rekomandohet :

1. ***Administrimi i plazheve, i stacioneve të plazheve dhe shërbimeve turistike*** duhet të jetë një e drejtë ekskluzive e bashkive, si promovuese dhe ofruese të shërbimeve turistike në territorin që mbulojnë
2. Decentralizim i menaxhimit ***të destinacioneve lokale, eventeve dhe produkteve turistike*** nevojitet të krijojë më shumë mundësi për bashkitë për nxitjen e turizmit dhe shtimin e numrit te turistëve

Kadastra

Kadastra urbane vijon të mbetet një shqetësim për qytetarët tanë, ndërkohë që ofrimi i shërbimit gjatë gjithë kohës ka qënë përgjegjësi e qeverisë qendrore. Vështirësit dhe pengesat që hasin qytetarët në regjistrimin dhe administrimin e pronave, shpesh herë I detyrojnë ata t'i drejtohen bashkive. Edhe vetë ASHK kur ndesh vështirësi dhe problematika i drejtohet bashkisë për qartësim të situatave dhe konflikteve.

1. Bashkitë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në legalizimin e banesave dhe AMPT-ve (akti i marrjes të tokës në përdorim).
2. Praktikisht, bashkitë nuk kanë akses në sistemin digjital online të kadastrës dhe pse ligjërisht është e rregulluar. Sugjerojmë vënien në zbatim të dispozitave përkatëse.
3. Një cështje tjetër për tu adresuar është dhe unifikimi i hartave kadastrale të institucioneve të ndryshme (bashki dhe AShK), të cilat shpesh herë kanë mospërputhje.

Shërbimi shëndetësor parësor

Shërbimi shëndetësor është pothuaj një shërbim që ofrohet tërësisht nga ministria përkatëse përgjegjëse për shëndetin publik. Megjithëse në pamundësi për ta ushtruar këtë funksion në gjithë territorin dhe mbulimin e të gjithë territorit me këtë shërbim. Mungesa e kontrollit mbi shërbimin në cdo pjesë të territorit dhe mungesa e kapaciteteve të zyrave të dekoncentruara, e bëjnë të domosdoshme decentralizimin e pjesshëm të shërbimit parësor tek bashkitë. Konkretisht:

1. Bashkitë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin jo vetëm të objekteve, por ***edhe të shërbimit shëndetësor parësor, jo klinik***.
2. Strukturat e bashkisë mund të menaxhojnë këtë shërbim për territoret që mbulojnë, duke koordinuar me strukturat qendrore dhe ato të dekoncentruara shëndetësore.
3. Sugjerohet decentralizimi i portalit për infermierët në rang bashkie.

Arsimi professional dhe nxitja e punësimit

Ndërkohë që bashkia ka përgjegjësi të vetën mbështetjen e shtresave në nevojë nëpërmjet pagesës së ndihmës financiare, por edhe njeh mirë nevojat e biznesit dhe tregut të punës, programet e nxitjes së punësimit dhe mbështetja e tregut nëpërmjet formimit profesional, vazhdon të mbetet

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

përgjegjësi e institucioneve qendrore. Rekomandohet decentralizim i funksioneve në vijim...

1. Arsimi profesional dhe qendrat e formimit professional kanë sot administrim qendror, ndërkohë që bashkitë janë njohëse dhe bashkëpunueset më të afërta me biznesin lokal dhe njohëse të mira të nevojave të tyre. ***Mbështetja e bizneseve me përgatitjen e specialistëve dhe formimin profesional të punonjësve të tyre, mund të realizohet nga ana e bashkive dhe institucioneve në varësi të saj***.
2. Zyrat lokale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit, janë institucione të dekoncentruara që financojnë projekte për nxitjen e punësimit, ndërkohë që trajtimi i të papunëve dhe referimi i tyre bëhet nga ana e bashkive. Koordinimi ndër-institucional kryhet formalisht dhe shpesh paqartësia e kompetencave dhe financimi i dyfishtë kërkon përpjekje të shtuara. ***Kalimi i administrimit të projekteve për nxitjen e punësimit tek bashkitë do të sjellë efektivitet dhe eficencë në mbështetjen e biznesit dhe nxitjen e punësimit.***

Shtylla 2: Financat vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore nevojitet të konsolidojnë financat e tyre dhe të mund të jenë të pavarura financiarisht. Qeveria nevojitet të ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të forcimit të autonomisë vendore dhe vecanërisht të autonomisë financiare.

1. ***Financat vendore nevojitet të konsolidohen më tej*** me ritme më të larta nga viti në vit nëpërmjet rritjes së mbështetjes nga buxheti i shtetit duke kaluar nga niveli 1% i PBB drejt arritjes së financimit në masën prej 2-5% të PBB për njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe duke krijuar hapësira të reja ligjore për rritjrn e të ardhurave të veta nga ana e bashkive.
2. Rekomandohet ***rritje e numrit të taksave të ndara*** si dhe ***rritje e % së ndarjes*** së atyre ekzistuese në favor të bashkive, sic është psh rasti i ndarjes së rentës minerare, ku përqindja në favor të bashkive nevojitet të rritet ndjeshëm.
3. ***Rishikimi i formulës së ndarjes të transfertës së pakushtëzuar***, duke shtuar kritere të reja që lidhen me numrin e funksioneve, kompetencave dhe shërbimeve shtesë të ofruara nga bashkitë. Vecanërisht kritere që lidhen me relievin, me turizmin, me profilet e bashkive, me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, minierave, etj. duhen konsideruar si kritere përbërëse të formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar.
4. ***Krijimi i kadastrës fiskale*** është një nga mundësitë reale për rritjen e të ardhurave dhe taksimin e drejtë të banesave dhe trojeve, por nevojitet mbështetja e qeverisë për krijimin e kadastrës fiskale. Administrimi i saj nga bashkitë do të përmirësojë ndjeshëm buxhetin dhe kontrollin e territorit.

Formula e Transfertës së Pakushtëzuar

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Në qendër të politikave publike janë ndryshimet në mekanizimin e formulës së Transfertës së Pakushtëzuar. Strategjia e re Ndërsektoriale e Decentralizimit 2023-2030, parashikon një sërë reformash në forcimin e rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore jo vetëm në ofrimin e shërbimeve thelbësore por edhe autonominë financiare.

Pavarësisht përpjekjeve të bëra për rritjen e autonomisë fiskale të pushtetit vendor, por edhe për të krijuar rregulla fiskale që do ti siguronin mekanizma të qëndrueshëm financimi, bashkitë vazhdojnë të përballen me probleme që kanë nevojë për ndërhyrje. Rritja e standardit të shërbimeve publike, forcimi i kapacitetit fiskal dhe përmirësimi shërbimeve administrative të njësive të vetëqerisjes vazhdon të mbetet një sfidë për të cilën bashkitë vlerësojnë që është momenti i duhur për të ndërhyre.

Ky dokument pasqyron qëndrimin e bashkive në evidentimin e problematikave të financimit të pushtetit vendor pas reformës administrativo territoriale dhe ka për qëllim që ti ofrojë pushtetit qëndror një mekanizmën që përmirëson situatën financiare në drejtim të:

- Barazisë së financimit të njësive të vetëqeversjes vendore, duke eleminuar diferencat e mëdha të krijuara në vite.
- Rritjes së Transfertës së Pakushtëzuar në raport me Produktin e Brendshëm Bruto.
- Forcimit të kapacitetit fiskal të pushtetit vendor përmes autonomisë në vendosjen dhe menaxhimin e të ardhurave të veta.


Përshkrimi i problematikave

Shqipëria ka nivelin më të ulët të financimit të pushtetit vendor në vetëm 3.8% të PBB-së, krahasuar me Bashkimin Europian prej 11.4% dhe vendet e ballkanit me 5.6% të PBB-së. Aspekt ky i rëndësishëm, për të evidentuar humbjen e mundësisë së Shqipërisë për të ndjekur të paktën trendin e financimit të pushtetit vendor në Europën Juglindore.

në Produktin e Brendshëm Bruto (Në pothuajse të gjitha vendet evropiane, edhe ato më të decentralizuarat, transfertat e pakushtëzuara, janë një shtyllë kryesore e financimit të qeverisjes vendore, pavarësisht organizimit respektiv. Sistemi i financimit nëpërmjet trasnfertës së pakushtëzuar, është një tregues i autonomisë reale vendore, po aq sa sistemi i taksave lokale. Prandaj ky sistem duhej të garantojë parashikueshmëri dhe pavarësi nga vendimet politike si dhe barazi e qëndrueshmëri, nëpërmjet mekanizmave të indeksimit e kompensimit. Pavarësisht se ligji për financat e vetëqeverisjes vendore ankoroi dhe stabilizoi transfertën e pakushtëzuar 1%), qeveria qendrore nuk e ka rritur këtë burim me shume se sa rritja nominale e vetë PBB-së.

Grafiku: Treguesit e të ardhurave vendore krahasuar me vendet e Europës Juglindore

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al



Burimi: NALAS (https://nalas-observatory.eu/)

Qëndrimi i bashkive mbi Transfertën e Pakushtëzuar

Bashkitë në procesin e konsultimit nën drejtimin e Shoqatës përmes analizës së treguesve financiarë kanë formuluar propozime konkrete të argumentuara lidhur madhësinë e fondit të Transfertës së Pakushtëzuar por edhe formulën aktuale të shpërndarjes së këtij fondi që miratohet në ligjin vjetor të buxhetit. Propozimet konkrete të bashkive mbi Transfertën e Pakushtëzuar, në këtë dokument janë:

1. Rritja e transfertës së pakushtëzuar të paktën sa 1.2% të Produktit të Brendshëm Bruto dhe në një periudhë afatgjatë 2-5% të PBB-së.

   Pushteti vendor nga momenti i miratimit të ligjit për financat vendore, ka marrë në formën e transfertës së pakushtëzuar të paktën 1% të PBB-së vjetore.

2. Impakti i CENSUS 2023, duhet të sigurohet stabiliteti financiar i bashkive.

   Një aspekt nga i cili bashkitë pritet të kenë impaktin më të madh janë rezultatet që do të reflektojë CENSUS 2023 mbi popullsinë në vend, duke reflektuar edhe lëvizjet emigratore (nga brënda Shqiprisë jashtë) dhe migratore (nga një bashki në tjetrën). Duke ju referuar formulës aktuale, ku 80% e transfertës shpërndahet mbi bazë popullsie atëherë impakti, kryesisht në bashki të vogla (ku varësia nga transferta është shumë e madhe), do të jetë i ndjeshëm që mund të cënojë stabilitetin financiar dhe si rrjedhim shërbimet publike vendore. Në këtë drejtim ky dokument propozim i bashkive

   Praktikisht duke ndryshuar peshën që zë popullsia (në rreth 70%) në formulën e transfertës aktuale, në drejtim të rritjes së kritereve të tjera si dëndësia e popullsisë (në 20%) dhe numri i

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

nxënësve (10%) do të ekuilibronte shpërndarjen ndërmjet njësive duke ju referuar faktit që bashkitë me densitet me të ulët përfitojnë më shumë fonde. Rritja e peshës së dendësisë në formulën e transfertës, sëbashku me mbështetjen e bashkive me dendsitet më të ulët duhet të mbajë gjithashtu në vemendje sezonalitetin e bashkive që përballojnë flukse turisitike në mënyrë që të krijohet ekuilibër në financim.

3. Të forcohen kriteret e ekualizimit brenda Formulës së Transfertës së Pakushtëzuar.

Një ndër elementët e rëndësishëm që sipas treguesve të të ardhurave të veta vendore dhe shpenzimeve në nivel bashkie, nuk ka dhënë ndikimin e pritshëm në rolin e tij pas reformës, është mekanizimi i ekualizimit/barazisë. Ky mosfunksionim është reflektuar në krijimin e disa bashkive (bashki të vogla me popullsi) të varuara plotësisht nga transfertat e buxhetit qendror dhe disa bashki të tjera (më popullësi mbi 100 mijë banorë) të cilat sigurojnë pjesën më të madhe të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Nga ana tjetër, konstatohen diferenca mjaft të mëdha në kapacitetin fiskal për të mbledhur të ardhura në disa bashkive, krahasuar me të tjera.

Në formulën e transfertës së pakushtëzuar parashikohet që 15% e fondit të ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, duke çuar më shumë fonde te ato bashki që kanë dëndësi më të ulët të popullsisë, nisur nga kostot më të larta që ato kanë për të ofruar shërbime në një territor më të gjerë, mundësinë e kufizuar për ekonomi shkalle dhe kapacitatin e kufizuar fiskal. Në këtë kuadër, komponenti i dendësisë i transfertës së pakushtëzuar siguron që bashkitë të vendosen në një vijë të barabartë përsa i përket mundësisë së tyre për të ofruar shërbime të një cilësie të pranueshme e të ngjashme në territor.

Transferta e pakushtëzuar kryen edhe nje funksion të dytë – ekualizimin horizontal ndërmjet bashkive përsa i përket aftësisë së tyre për të mbledhur të ardhura. Si rregull, bashkitë me të ardhura mbi 120% të mesatares kombëtare nga taksat e ndara, duhet të paguajnë një kontribut për të krijuar një fond ekualizimi horizontal ndërmjet bashkive për të mbështetur bashkitë më kapacitatet më të ulët fisklal. Megjithatë, ndryshe nga ekualizimi vertikal nëpërmjet komponentit të dendësisë, madhësisa e ekualizimit fiskal horizontal përbën më pak se 2% të transfertës së pakushtëzuar. Në këtë kuadër, kur madhësia e fondeve është kaq modeste, ekualizimi horizontal nuk është në gjendje të arrijë objektivin e ekualizimit të bashkive përsa i përket kapacitetit fiskal.

Për sa shtrohet më sipër, pesha e kapacitetit fiskal në ekualizim duhet të rishikohet, në kushtet që diferencat e potencialit ekonomik lokal dhe potencialit të taksave lokale, variojnë shumë ndërmjet bashkive. Ky rregullim nuk synon barazimin e bashkive, por garantimin e një minimumi funksional shërbimesh publike për bashkitë të cilat, edhe pse mund të kenë një numër më të madh banorësh, apo sipërfaqe më të madhe, nuk kanë potencial ekonomik të mjaftueshëm për të funksionuar bazuar vetëm në të ardhurat e veta lokale.

Ekualizimi fiskal duhet të parashikohet me një peshë specifike në formulën e Transfertës së Pakushtëzuar, duke rishikuar peshat specifike të kritereve të tjera të parashikuara specifikisht në ligj: popullsia, dendësia dhe numri i nxënësve në arsimin parauniversitar.

Në përfundim, formula e trasfertës së pakushtëzuar ka nevojë të rishikohet në aspektin e komponentëve përbërës të saj, duke i zgjeruar me komponentë më domethënës si, kapaciteti fiskal, nevoja sociale (varfëria), etj., të cilët sigurojnë proporcionalitet dhe kohezion territorial.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Për këtë është e nevojshme që të bëhen simulime të ndryshme për të gjetur një mesatare të arsyeshme të peshës specifike të cdo komponenti, ku një shembull në parim (pa u bazuar në kalkulime konkrete), mund të ishte:

Popullsia 45%

Dendësia 15%

Sipërfaqja 15%

Varfëria (nevoja sociale) 10%

Kapaciteti fiskal 15%

Në një version më gjithëpërëfshirës, kriteret ku bazohet formula e transfertës, mund të zgjerohen edhe më tej me elementë të profilit ekonomik të bashkive, si sezonaliteti në rastin e bashkive me profil turistik apo bujqësia etj.

4. Mekanizmi i indeksimit

Një nga problemet që paraqet sot modeli i transfertës së pakushtëzuar është fakti që nuk ka një lidhje të qartë me zhvillimin ekonomik, inflacionin apo rritjen reale të kostove të shërbimeve publike vendore. Kjo krijon pasiguri fiskale për bashkitë dhe dobëson planifikimin shumëvjeçar.

Shumë modele moderne europiane të decentralizimit financiar kanë kaluar gradualisht drejt mekanizmave automatikë të indeksimit të transfertave të pakushtëzuara. Logjika e këtij mekanizmi është që financimi vendor të ndjekë automatikisht evolucionin e ekonomisë dhe të kostove publike.

Në thelb, indeksimi automatik nënkupton që transferta e pakushtëzuar rritet sipas një formule të paracaktuar në ligj, e lidhur me indikatorë objektivë makroekonomikë, si:

- inflacioni,
- rritja ekonomike,
- ose ecuria e të ardhurave tatimore kombëtare.

Kështu sigurohet një mekanizëm i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm që garanton përshtatjen automatike të transfertës me zhvillimet ekonomike të vendit. Një mekanizëm i tillë:

- do të krijonte stabilitet fiskal. Bashkitë mund të planifikojnë investime dhe politika shumëvjeçare, sepse kanë një pritshmëri më të qartë mbi evolucionin e të ardhurave të tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për investimet infrastrukturore, të cilat kërkojnë planifikim afatmesëm dhe afatgjatë.
- do të mbronte pushtetin vendor nga efektet e inflacionit. Në mungesë të indeksimit, edhe nëse transferta nominale mbetet e njëjtë, vlera reale e saj bie nga viti në vit, duke reduktuar gradualisht kapacitetin e bashkive për të ofruar shërbime publike..
- do të rriste gjithashtu disiplinën fiskale kombëtare. Duke qenë se formula është e paracaktuar dhe e lidhur me indikatorë makroekonomikë, edhe qeveria qendrore ka më shumë parashikueshmëri mbi angazhimet e saj financiare ndaj pushtetit vendor.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

- Për sa më sipër, mund të ishte më vend që këto modele evropiane të konsideroheshin edhe në rastin e Shqipërisë, duke parashikuar që transferta e pakushtëzuar:

- të ketë një bazë minimale të garantuar ndaj GDP-së, në 1.2% ose më shumë;
- të indeksohet automatikisht çdo vit sipas inflacionit dhe/ose rritjes së të ardhurave tatimore kombëtare.

Një formulë e tillë do të krijonte një lidhje më organike midis zhvillimit ekonomik të vendit dhe financimit të pushtetit vendor, duke e bërë decentralizimin financiar më real dhe më të qëndrueshëm.

5. Mekanizmi i kompensimit të të ardhurave të munguara

Mekanizmi i kompensimit për pushtetin vendor lidhet me një problem shumë të zakonshëm në vendet me decentralizim të pjesshëm: qeveria qendrore shpesh merr vendime fiskale me efekt direkt mbi të ardhurat e bashkive, pa kompensuar humbjet që krijohen në nivel vendor.

Kjo ndodh, për shembull, kur:

- ulen ose hiqen taksa lokale,
- jepen përjashtime fiskale,
- reduktohen tarifa,
- ose ndryshohet baza tatimore e pushtetit vendor.

Parimi është i thjeshtë: nëse qeveria qendrore merr një vendim që redukton të ardhurat vendore, atëherë shteti duhet të kompensojë automatikisht diferencën financiare.

Ky mekanizëm është shumë i rëndësishëm sepse mbron parimin bazë të Kartës Europiane të Vetëqeverisjes Vendore:

kompetencat dhe përgjegjësitë vendore duhet të shoqërohen me burime të mjaftueshme financiare.

Në mungesë të një mekanizmi kompensimi, çdo vendim i tillë cënon drejtpërdrejt autonominë financiare të bashkive përvec që i vendos ato në vështirësi financiare të papritura.

Për këtë arsye, shumë vende europiane kanë ndërtuar mekanizma ligjorë që garantojnë kompensim automatik për çdo humbje të ardhurash të shkaktuar nga politika fiskale qendrore. Një mekanizëm I tillë, është I parashikuar në ligjin për pushtetin vendor, por nuk është I rregulluar mjaftueshëm dhe nuk ka gjetir zbatim deri më sot, në raste të tilla.

Në praktikë, mekanizmi i kompensimit duhet të funksionojë përmes një formule të paracaktuar në ligj, ku Ministria e Financave llogarit efektin fiskal të ndryshimit ligjor mbi të ardhurat vendore dhe transferon automatikisht fondin kompensues në buxhetet e bashkive.

Kjo shmang situatat ku pushteti vendor humbet të ardhura, por nuk merr financim shtesë, duke u detyruar të reduktojë investimet apo shërbimet publike.

© 2026 Shoqata Kombetare e Bashkive te Shqiperise
www.shkb.al

Për Shqipërinë, një mekanizëm i tillë do të kishte rëndësi të veçantë, sepse sistemi aktual mbetet relativisht i centralizuar dhe bashkitë kanë ende bazë fiskale të kufizuar. Në këto kushte, ndryshimet fiskale të marra në nivel qendror mund të kenë ndikim disproporcional mbi financat vendore.

Vendosja e kompensimit automatik do të krijonte:

- më shumë siguri fiskale për bashkitë,
- më shumë besueshmëri institucionale,
- dhe një autonomi financiare më reale.

Në të njëjtën kohë, ky mekanizëm do të rriste transparencën fiskale kombëtare, sepse çdo politikë e re fiskale do të duhej të shoqërohej paraprakisht me analizë të ndikimit financiar mbi pushtetin vendor dhe me identifikimin e burimit të kompensimit.

Në terma afatgjatë, mekanizmi i kompensimit nuk është thjesht instrument teknik financiar, por një garanci institucionale që decentralizimi fiskal të mos mbetet formal, por të funksionojë realisht në praktikë.

Fondi i komensimit mund të bëhet ose jo, pjesë e transfertës së pakushtëzuar të vitit kur ndodh ndryshimi.

6. Sugjerojmë që pas disa viteve të transferimit të disa funksioneve në nível vendor, është koha që transfertat për këto funksione të mos jenë më të kushtëzuara por të jenë pjesë e grantit të pakushtëzuar. Mënyra si llogariten transferta specifike zakonisht nuk mbulon të gjitha shpenzimet e nevojitura për staf dhe mirëmbajtje.

7. Shpërndarja e granteve për investime duhet të shihet në nivel rajoni, duke u shoqëruar me një formulë dhe mekanizëm përkatës në mënyrë që të përfitojnë as më shumë bashki.

Taksat e Ndara

Decentralizimi fiskal përbën një nga shtyllat kryesore të reformës së qeverisjes vendore dhe synon forcimin e autonomisë financiare të bashkive, rritjen e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike dhe përmirësimin e llogaridhënies ndaj qytetarëve. Reformat e ndërmarra që prej mesit të viteve 2010 kanë zgjeruar kompetencat e bashkive dhe kanë përmirësuar kuadrin e financimit vendor.

Sipas të dhënave të NALAS Observatory dhe analizave të institucioneve ndërkombëtare, të ardhurat totale të pushtetit vendor në Shqipëri luhaten rreth 3.5–4% të PBB-së, duke e renditur vendin ndër nivelet më të ulëta në Evropën Juglindore. Në krahasim, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor regjistrojnë nivele ndërmjet 4–6% të PBB-së, ndërsa në disa vende anëtare të Bashkimit Europian në rajon ky tregues tejkalon 7–8% të PBB-së.

Bashkitë shqiptare vazhdojnë të karakterizohen nga:

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

- varësi e lartë nga transfertat e qeverisë qendrore;
- kapacitete të kufizuara për gjenerimin e të ardhurave të veta;
- pabarazi të konsiderueshme ndërmjet bashkive urbane dhe rurale;
- autonomi e kufizuar mbi instrumentet kryesore fiskale.

Aktualisht, financimi vendor mbështetet kryesisht në taksat dhe tarifat vendore, transfertat nga buxheti i shtetit, taksat e ndara, donacionet dhe huamarrjen vendore. Megjithatë, pesha e taksave të ndara në financat vendore mbetet relativisht e ulët. Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" parashikon që bashkitë të përfitojnë:

- 97% të të ardhurave nga taksa e transferimit të së drejtës së pronësisë;
- 25% të të ardhurave nga taksa e qarkullimit të mjeteve të përdorura;
- 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale;
- 4-10% të të ardhurave nga renta minerare, sipas kategorive të mineraleve.

Për periudhën 2020–2025, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përfituar rreth 6.49 miliardë lekë nga pjesa prej 2% e tatimit mbi të ardhurat personale. Ndërkohë, të ardhurat nga renta minerare për periudhën 2022–2025 rezultojnë rreth 245.8 milionë lekë, nga taksa e transferimit të pronësisë rreth 647.5 milionë lekë vetëm për vitin 2025, ndërsa nga taksa e mjeteve të përdorura rreth 1.2 miliardë lekë për 2025.

Në praktikë, ky model mbetet më i centralizuar krahasuar me shumicën e vendeve të rajonit dhe Bashkimit Europian. Në disa vende të rajonit, njësitë vendore përfitojnë nivele dukshëm më të larta të ndarjes së tatimit mbi të ardhurat personale krahasuar me Shqipërinë, ndërsa mekanizmat e ekualizimit fiskal dhe autonomia mbi taksën e pronës janë më të forta.

Greqi, financimi i pushtetit vendor mbështetet kryesisht në ndarjen e të ardhurave nga taksat kombëtare. Bashkitë përfitojnë 21.3% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe të bizneseve, 12% të të ardhurave nga TVSH-ja dhe 50% të të ardhurave nga taksa mbi pasurinë.

Çeki, pushteti vendor ka nivel të lartë autonomie fiskale. Burimi kryesor i financimit janë taksat lokale dhe taksat e ndara, ku TVSH-ja përbën rreth 40% të të ardhurave tatimore vendore. Të ardhurat nga tarifat dhe shërbimet lokale përfaqësojnë rreth 14% të totalit të të ardhurave vendore. Në vitin 2018, niveli vendor kishte një varësi nga transfertat prej 42.

Italia, sistemi i decentralizimit është më i zhvilluar në nivel rajonal. Rajonet financohen kryesisht nga taksa rajonale, pjesa nga TVSH-ja dhe tatimi mbi të ardhurat personale, ndërsa bashkitë mbështeten te taksat mbi pronën. Shpenzimet e pushtetit vendor përbëjnë 29% të totalit të shpenzimeve publike, ku rajonet zënë rreth 22% dhe bashkitë afro 10%. Sistemi italian kombinon të ardhurat e veta me mekanizma të fortë të ekualizimit fiskal.

Mali i Zi, të ardhurat e pushtetit vendor përbëhen nga të ardhurat e veta, taksat e ndara, fondi i ekualizimit dhe grantet nga qeveria qëndrore. Në vitin 2011, të ardhurat e veta përbënin 54% të totalit të të ardhurave vendore, taksat e ndara 14.9%, fondi i ekualizimit 10.8% dhe transfertat e tjera 1.1%. Bashkitë përfitojnë gjithashtu 12% të tatimit mbi të ardhurat personale.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Maqedonia e Veriut, decentralizimi fiskal është zhvilluar gradualisht që prej vitit 2005, por bashkitë mbeten shumë të varura nga grantet qendrore. Të ardhurat e veta reale, kryesisht nga taksa e pronës dhe tarifat bashkiake, përbëjnë 29% të të ardhurave vendore. Grantet bllok përfaqësojnë 53%, taksat e ndara 6% dhe grantet e dedikuara 12%.

Serbia, të ardhurat e pushtetit vendor përbëhen nga 41% të ardhura e veta, 40% taksa të ndara, 18% grante të pakushtëzuara dhe 1% grante të kushtëzuara. Të ardhurat e veta bazohen kryesisht në tarifat bashkiake, taksat mbi pronën dhe tarifat për zhvillimin e tokës.

Sllovenia, burimi kryesor i të ardhurave është tatimi mbi të ardhurat personale (PIT), i cili përbënte 55.5% të të ardhurave bashkiake në vitin 2017. Ky tatim mblidhet nga qeveria qendrore dhe rishpërndahet sipas nevojave fiskale dhe kapaciteteve të bashkive. Të ardhurat e tjera përfshijnë taksa lokale dhe tarifa bashkiake, ndërsa grantet përdoren për të mbuluar diferencat.

Suedia, pushteti vendor gëzon një nga nivelet më të larta të autonomisë fiskale në Evropë. Rreth dy të tretat e të ardhurave vendore vijnë nga taksat lokale mbi të ardhurat. Grantet e përgjithshme nga qeveria qendrore përbëjnë rreth 15% për bashkitë dhe 9% për qarqet, ndërsa grantet e dedikuara rreth 3–4%. Tarifat dhe pagesat për shërbime përfaqësojnë rreth 6% të të ardhurave të bashkive dhe 3% të qarqeve.

Rekomandime

Për të forcuar decentralizimin fiskal dhe autonominë vendore rekomandohet zgjerimi gradual i autonomisë fiskale të bashkive me qëllim forcimin e autonomisë fiskale të bashkive përmes një kombinimi më të qëndrueshëm të të ardhurave nga burimet e veta dhe një administrimi më të fortë të taksave vendore me synimin ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të njësive vendore.

1. Rritja graduale e taksave të ndara

- Rekomandohet rishikimi progresiv i formulës së ndarjes së **tatimit mbi të ardhurat personale,** me synim afrimin gradual me praktikat e vendeve të rajonit dhe Bashkimit Europian. Aktualisht, Shqipëria transferon vetëm 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale tek njësitë vendore, ndërkohë që në vende të tjera të rajonit niveli i pjesëmarrjes së pushtetit vendor në këtë taksë është dukshëm më i lartë. Për vitin 2025 bashkia Tiranë ka përfituar 22% të të ardhurave, Bashkia Durrës 6.8%, Bashkia Shkodër 4.9%.

  Nëse i referohemi rajonit por dhe vëndeve të BE rezulton se psh: Ne Greqi njësitë vendore përfitojnë 21.3% e të ardhurave totale vjetore nga tatimi mbi të ardhurat e personave fizikë dhe personave juridikë. Në Maqedoninë e Veriut kjo normë është 4-6%, ndërkohë që Serbia ka një nga modelet më të decentralizuara në rajon për TAP ku bashkitë përfitojnë rreth 74% të tatimit mbi pagat/personale. Në Kroaci, rreth 74% e tatimit mbi të ardhurat personale shkon për njësitë vendore, ndërsa Mali i zi 12%.

- Rekomandohet rritja graduale e pjesës së **rentës minerare** që transferohet tek njësitë vendore, veçanërisht në zonat ku zhvillohet aktiviteti nxjerrës, të cilat kanë probleme të ndjeshme

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

mjedisore dhe sociale, me synim afrimin gradual drejt niveleve 30–50%, në përputhje me parimin e kompensimit territorial dhe zhvillimit lokal. *Për vitin 2025 për llogari të Bashkive janë transferuar 124 milionë lekë të ardhura, bashkitë që kanë përfituar 67% të totalit janë (Bashkia Patos ka përfituar 31% të totalit, Roskoveci 20% Bulqiza 16 %). Rritja e % sipas mineraleve deri në 25% do të ketë ndikim të ndjeshëm në të ardhurat e bashkive (jo proporcionalisht) duke mos e demtuar buxhetin e shtetit)*.

- Rekomandohet të vlerësohet përdorimi i një pjese të të ardhurave nga **TVSH**-ja si bazë për forcimin e mekanizmave të grantit të pakushtëzuar dhe barazimit fiskal, sipas praktikave të aplikuara në disa vende europiane. Një qasje e tillë do të kontribuonte në reduktimin e pabarazive ndërmjet bashkive dhe në forcimin e kohezionit territorial. TVSH është një nga taksat më të mëdha kombëtare dhe zakonisht administrohet plotësisht nga qeveria qendrore.

Në shumë vende të BE-së TVSH nuk transferohet drejtpërdrejt tek bashkitë, por përdoret si bazë financimi për grantet e barazimit. Të ardhurat nga ky tatim shpërndahen nëpëmjet transfertës.

Në rajon Greqia përfiton 12% të të ardhurve vjetore nga TVSH, në Ceki kontributi është në masën 40% nga tvsh.

- Bashkitë mund të përfitojnë dhe nga ndarja e **Tatimit mbi fitimin**. Bashkitë të cilat kanë në territorrin e tyre numër të lartë biznesesh do të përfitojnë nga kjo ndarje. Të ardhurat e ndara nga ky tatim mund të rishpërndahen dhe në bashki të tjera, me më pak biznese, duke mundësuar dhe ekualizimin financiar mes bashkive.
- Rekomandohet të vlerësohet mundësia e transferimit të të ardhurave të gjeneruara nga **zonat e mbrojtura mjedisore**, me rëndësi të veçantë për vlerat e tyre natyrore, ekonomike apo sociale, si pjesë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit. Aktualisht Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM-ja) është përgjegjëse për administrimin e të gjitha të ardhurave të realizuara nga aktiviteti ekonomik në territorin e zonave të mbrojtura mjedisore.

  Zonat e mbrojtura nuk kanë një "taksë" specifike, por aplikohen tarifa përdorimi dhe hyrjeje për aktivitete turistike, rekreative apo ekonomike brenda tyre. Këto tarifa derdhen në buxhetin e shtetit dhe administrohen nga institucionet përgjegjëse për mjedisin dhe zonat e mbrojtura. Niveli i këtyre tarifave është shume i ulët, dhe varion nga

  - 50 lekë/ditë për vizitorët në këmbë ose me biçikletë;
  - 150 lekë/ditë për automjetet;
  - 500 lekë/ditë për autobusët;
  - tarifa për kamping nga 150 deri në 1,000 lekë/ditë sipas llojit të akomodimi
  - etj tarifa.

2. Përshpejtimi i reformës së taksës së pronës

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Normat e taksës së pasurisë në Shqipëri mbeten të ulëta krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe ato të BE-së, ndërsa baza e taksimit nuk pasqyron vlerat reale të tregut. Për më tepër, ekzistojnë boshllëqe të konsiderueshme në mbulimin e pronave për shkak të regjistrimit jo të plotë, ndërtimeve informale dhe fragmentimit të sistemeve të të dhënave.
E nisur prej vitesh por e pa finalizuar është një nga mundësitë reale për rritjen e të ardhurave dhe taksimin e drejtë të banesave dhe trojeve drejt mënyrës së taksimit mbështeur në vlerën e tregut

Vendi	**Lloji/Përdorimi Ndërtesës, toka**	**Norma minimale (%)**	**Norma maksimale (%)**
Shqipëria	Rezidenciale	0.035	0.065
Kosova	Rezidenciale	0.15	1.00
Mali i Zi	Rezidenciale	0.25	1.00
Maqedonia e Veriut	Rezidenciale	0.10	0.20
Serbia	Rezidenciale	0.00	0.40
Mesatarja e Bashkimit Evropian	Rezidenciale	0.50	1.49

Eektiviteti i reformës së taksës mbi pronën në Shqipëri do të varet nga harmonizimi i tre shtyllave që forcojnë njëra-tjetrën: një kadastër fiskale e besueshme, një lidership i fortë politik i mbështetur nga një strategji koherente komunikimi dhe një administratë tatimore e aftë për të shndërruar përmirësimin e të dhënave në përputhshmëri të qëndrueshme dhe rritje të të ardhurave.
Megjithatë, ky transformim kërkon gjithashtu që bashkitë, të modernizojnë praktikat e administrimit tatimor, të largohen nga proceset e fragmentuara dhe manuale, si dhe të zhvillojnë kapacitetet për të përdorur në mënyrë efektive të dhënat e përbashkëta kombëtare për faturimin, zbatimin dhe menaxhimin e përputhshmërisë tatimore.

- Të zbatohet ligji për ndarjen e të ardhurave nga taksa për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
- Rekomandojmë rritjen e përqindjes së taksës së qarkullimit përtej 25%.

Shtylla 3: Territori dhe qeverisja

Harta territoriale

Harta territoriale konsiderohet si një element i rëndësishëm që do të finalizojë procesi i rishikimit të RAT, por gjithsesi jo si i vetmi. Bashkia mbetet njësia themelore dhe e pandryshueshme e vetëqeverisjes vendore. Reforma nuk prek modelin e brendshëm të vendimmarrjes bashkiake, i cili vazhdon të funksionojë mbi parimet e autonomisë lokale, subsidiaritetit dhe llogaridhënies demokratike. Ndryshimet në hartën territoriale nevojitet të realizohen si pjesë e një procesi të gjithanshëm që konsideron shumë faktorë dhe që ndikon direkt në cilësinë e jetës së banorëve. Si

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

e tillë, cdo ndryshim duhet të realizohet me bashkëpunimin dhe pëlqimin e banorëve që preken dhe në interes të tyre.

1. Rishikimi i ndarjes territoriale duhet të bazohet tek ***funksionaliteti, por gjithashtu edhe tek traditat, kultura dhe historia*** e zhvillimit të territorit ndër vite. Mendimi qytetar është i rëndësishëm dhe duhet marrë në konsideratë përpara marrjes së cdo vendimi për ndryshim kufijsh dhe riorganizim territori.
2. Për cdo ndryshim të hartës ekzistuese (bashki, NjA, fshat), Komisioni duhet të realizojë një konsultim të vecantë me banorët që preken dhe të organizojë anketa/pyetësorë, rezultatet e të cilave duhet të bëhën publike dhe të merren në konsideratë.

Nivelet e vetëqeverisjes vendore

Qeverisja vendore me dy nivele është komplekse dhe ka nevojë për qartësim dhe regullim kompetencash ndërmjet dy niveleve të qeverisjes. Ndryshimi i numrit të bashkive për cdo qark, nevojitet të shoqërohet me ndryshim të numrit të qarqeve/ rajoneve duke siguruar një përshtatje që siguron bashkëjetësën dhe koordinimin ndërmjet tyre.

1. Përcaktimi i ndarjeve të fushave të veprimtarisë dhe kompetencave ndërmjet bashkive dhe qarqeve duhet të jetë i qartë në ligjin për vetëqeverisjen vendore.
2. Mundësitë e bashkëpunimit dhe koordinimit duhet të përcaktohen me ligj dhe marrëveshje të vecanta.

Rritje e nivelit të përfaqësimit

Ka një ndjesi të shprehur nga ana e banorëve të zonave rurale dhe NjA në përgjithësi në lidhje me nivelin e përfaqësimit të tyre në organet e bashkive të reja të krijuara pas riorganizimit territorial. Përgjithësisht banorët e zonave rurale ndjejnë ulje të përfaqësimit të tyre ne organet e reja, si në këshillin e bashkisë ashtu edhe në përfaqësimin në NjA. Gjithsesi rreth 3000 këshilltarë më pak në këshillat bashkiake të reja, mungojnë pikërisht nga zonat rurale (ish komunat) dhe kjo e bën të natyrshme këtë ndjesi. Por mundësitë e rritjes së përfaqësimit nevojitet të rishikohen me kujdes, me qëllim që të kemi përfaqësim proporcional në këshilla, administratë dhe mbështetje financiare për cdo zonë të bashkisë.

Në vijim jepen disa konstatime dhe rekomandime:

1. Partitë politike në 10 vitet e fundit nuk kanë shprehur vullnetin e nevojshëm për të garantuar nivel të barabartë përfaqësimi në këshillat bashkiake ndërmjet banorëve të zonave urbane dhe atyre rurale. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillave bashkiake nevojitet të ndryshojë me qëllim dhënien e mundësisë ***për banorët e NjA të votojnë për të patur përfaqësuesit e tyre në këshillat bashkiake.***
2. **Kufizimi i numrit të mandateve** për kryetarët e bashkive i vendosur në vitin 2015 mund

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

të shfuqizohet me këtë reformë të pushtetit vendor.

3. Rishikimi i statusit të Administratorit të NjA, i mënyrës së emërimit të tyre me synimin e arritjes së një konsensusi sa më të gjerë në përzgjedhjen e administratorëve bazuar në kritere të qarta dhe procedura të përcaktuara qartë.
4. NjA nevojitet të kenë buxhetin e tyre që buron nga e drejta e ***rishpërndarjes së Transfertës së Pakushtëzuar (TP) për cdo NjA*** në përputhje me të njëjtat kritere që TP shpërndahet ndërmjet bashkive.
5. Kompetencat e NjA të parashikuara në ligj janë të kufizuara. Ndërkohë kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiake, megjithëse ligji parashikon mundësi delegimi kompetencash, përgjithësisht nuk kanë deleguar kompetenca tek njësitë administrative. Rekomandohet që ligji të shprehë në mënyrë të qartë më shumë kompetenca për NjA dhe administratorët.
6. ***Investimet publike nevojiten të rishpërndahen proporcionalisht ndërmjet NjA*** në përputhje me kontributin e secilës si dhe bazuar në nevojat e secilës dhe detyrimin për zhvillim të barabartë.
7. ***Sigurimi i një balance*** ndërmjet "ekonomisë së shkallës" dhe "përfaqësimit vendor" nevojitet të konsiderohet në cdo hap të rishikimit të reformës.

Rajonet Zhvillimore – Një Nivel i Ri Territorial

Reforma duhet të parashikojë krijimin e rajoneve zhvillimore si një nivel i ri territorial dhe funksional, të dallueshëm nga qarqet ekzistuese.

Ky nivel nuk duhet të konsiderohet si vazhdim apo riemërtim i strukturave aktuale, por si një arkitekturë e re institucionale e konceptuar sipas logjikës së njësive NUTS 2 të Bashkimit Europian.

- Numri i rajoneve zhvillimore mund të luhatet në një diapazon prej 4–5 rajonesh, duke reflektuar:
- koherencën gjeografike;
- lidhjet ekonomike dhe sociale;
- kapacitetin zhvillimor;
- përputhshmërinë me programimin e fondeve europiane.

Rajoni zhvillimor nuk zëvendëson bashkinë, por plotëson funksionet e saj për çështje që tejkalojnë territorin ose kapacitetin e një bashkie individuale.

Gjithashtu, rishikimi i numrit të qarqeve/rajoneve duhet të shoqërojë çdo rishikim të numrit të bashkive, duke garantuar koordinim territorial dhe zhvillim harmonik.

Funksionet Rajonale

Rajoni duhet të organizojë dhe koordinojë funksione dhe shërbime që nuk mund të ofrohen në mënyrë efikase nga bashkitë individuale.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

Këto përfshijnë:

- planifikimin strategjik rajonal;
- koordinimin hapësinor ndërmjet bashkive;
- infrastrukturën dhe shërbimet ndërbashiake;
- menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- rrjetet rajonale të ujësjellësit;
- transportin ndërkomunal;
- zhvillimin ekonomik rajonal;
- zonat ekonomike dhe korridoret e investimeve;
- arsimin profesional dhe shërbimet e specializuara me kosto të lartë.

Rajoni duhet të ketë gjithashtu rol mbështetës për bashkitë me kapacitete të kufizuara, përmes:

- shërbimeve teknike të përbashkëta;
- instrumenteve financiare rajonale;
- kapaciteteve administrative të ndara.

Programet e Kohezionit dhe Partneriteti me BE-në

Rajoni zhvillimor duhet të funksionojë si strukturë e certifikuar për programimin, menaxhimin dhe zbatimin e fondeve të Bashkimit Europian.

Kjo përfshin:

- programimin e fondeve IPA;
- menaxhimin e fondeve strukturore dhe të kohezionit pas anëtarësimit;
- menaxhimin e instrumenteve territoriale të integruara;
- bashkëpunimin ndërkufitar dhe transnacional;
- sistemet e monitorimit, raportimit dhe auditimit sipas standardeve europiane.
- Lidhja ndërmjet reformës territoriale dhe instrumenteve europiane është jo vetëm teknike, por edhe strategjike dhe politike, pasi dëshmon kapacitetin institucional të shtetit për të absorbuar fondet europiane.

Bashkëpunimi Ndërbashkiak

Pavarësisht modelit rajonal që do të ndiqet, bashkëpunimi ndërbashkiak duhet të institucionalizohet si mekanizëm fleksibël dhe plotësues.

Instrumentet kryesore mund të përfshijnë:

- partneritete për ofrimin e shërbimeve;
- agjenci zhvillimi ndërkomunal;
- kontrata dhe marrëveshje ndërkomunale;

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

- instrumente financiare stimuluese për bashkëpunimin vullnetar.
- Kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë format e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.

Fshati

Fshati vijon të mbetet njësia bazë e bashkive dhe nevojitet të tregohet një kujdes i vecantë për banorët e tij. Renia e numrit të banorëve të fshatrave nuk duhet të dekurajojë organizimin i strukturave të fshatit dhe as rolin e tyre, por përkundrazi nevojitet të krijojë dhe forcojë struktura efektive që mundësojnë më shumë përfaqësim dhe kompetenca, që krijojnë kushte për rikthim të banorëve dhe jo braktisje të fshatit.

Në vijim jepen disa rekomandme në lidhje me strukturat komunitare në fshat.

1. Zgjedhja e kryesisë së fshatit dhe kryetarit të fshatit nevojitet të garantohet nëpërmjet procedurash që bëjnë të mundur organizimin real të procesit dhe zgjedhjen e përfaqësuesve të gjithëpranuar. Pjesëmarrja e më shumë se 50% e banorëve e bën realishte të pamundur procesin dhe krijon struktura dhe drejtues fiktivë dhe të papranuar, në shumicën e rasteve, të emëruar nga ana e kryetarit të bashkisë.
2. Dhenia e më shumë kompetencave kryetarit të fshatit dhe kryesisë, me qëllim forcimin e rolit të tij jo vetëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, por vecanërisht në përfaqësimin e komuniteteve para këshillave bashkiake.
3. Krijimi i raporteve të qarta ndërmjet NJA dhe fshatit dhe strukturave përkatëse, nevojitet të saktësohet në ligj me frymën e transmetimit të opinionit qytetar dhe përfaqësimit nga baza drejt qendrës

Digjitalizimi

Gjithkush konstaton lehtësisht një disnivel të dukshëm nëpërmjet shërbimeve digjitale të ofruara nga qeverisa qendrore krahasuar me atë në nivel vendor. Nevoja për digjitalizim të shërbimeve në nivel vendor vjen edhe më emergjente për shkak të rritjes së distancave nga banori deri tek qendra e bashkisë, për shkak të Reformës Administrative Territoriale. Prej vitesh ka një nevojë për “zvogëlim”të këtyre distancave përmes digjitalizimit të shërbimeve, gjë që nuk ka ndodhur.
Pavarësisht se edhe Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 evidenton këtë nevojë dhe e vendos atë si prioritet strategjik, edhe pse kanë kaluar më shumë se tre vite nga miratimi i saj, nuk ka asnjë përpjekje serioze për avancimin e procesit të digjitalizimit në nivel vendor.
Nëse duam të shkojmë më tej në thellimin e Reformës Administrative Territoriale, nevojitet të konsiderojmë si prioritet :

1. Mbështetjen e qeverisë për krijimin e një platforme të shërbimeve vendore ose përfshirjen e shërbimeve vendore në platformën e-Albania.
2. Krijimi i databases së të dhenave për cdo bashki dhe cdo fushë veprimtarie që ka të bëjë me

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

funksionet dhe shërbimet që ofrohen në nivelin vendor.

3. Detyrimi me ligj i ofrimit të shërbimeve online në platforma të dedikuara.
4. Forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të bashkive dhe vecanërisht të NJA në përdorimin e teknologjisë.
5. Mundësimi i ofrimit të asistencës së nevojshme nga ana e punonjësve të bashkisë dhe NjA për cdo banor, me qëllim përdorimin e teknologjisë dhe aplikimin online për shërbimet e nevojshme.

Ky dokument u draftua me mbështetjen e forumeve teknike, një pjesë e të cilave u mbështet nga projekti "Bashki të Forta", i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Ambasada Zvicerane në Shqipëri dhe Ambasada Suedeze në Tiranë, dhe zbatohet nga Helvetas. Gjithashtu, një pjesë e forumeve u mbështet nga projekti "Fuqizimi i Shoqatës Kombëtare të Bashkive", me financimin e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe mbështetjen e Rrjetit të Shoqatave të Autoriteteve Vendore në Europën Juglindore (NALAS), për konsolidimin e Shoqatës Kombëtare të Bashkive.

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al

© 2026 Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
www.shkb.al